



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. ____/____ Prot.

Fier, më 23.05.2025

Lënda: Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër, në përfundim të afateve të ankimit për procedurën me objekt “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

(për botim)

Shtojca 14

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

BASHKIA FIER

Data: 23.05.2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ X

G.P.G. COMPANY SHPK, me NUIS J64324443V me adresë Lushnje, Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut.

ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐ JO

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒ X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar-me mjete elektronike.

(Marreveshje Kuader me 1 (një) operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 36 muaj), me objekt **“Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”**

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-35889-01-23-2025.

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

“Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej : **249 470 651.69** (dyqind e dyzet e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose **fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 23.01.2025): 2 538 366.41** (dy milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje dyzetë e një) **Euro**, me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Fier.

Kohëzgjatja e kontratës: - 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **12/05/2025**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve [19 Maj 2025], [Numri 25].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik **BIBA-X SHPK , me numër NUIS K32618815N.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 144 656 156 (njëqind e dyzet e katër milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik **G.P.G. COMPANY SHPK, me numër NUIS J64324443V.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 165 098 873 (*njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori ekonomik **A.L-ASFALT SHPK, me numër NUIS K81511508A.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 205 352 480 (*dyqind e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori ekonomik **ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK, me numër NUIS K91628013D.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 217 039 407,60 (*dyqind e shtatëmbëdhjetë milion e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatë presje gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori ekonomik **PE - VLA - KU SHPK, me NUIS K61716013M.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 219 380 534 (*dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. **B.O.E COGREN SHPK me NUIS J74818825K & JODY-KOMPANY SHPK me NUIS J94824803M & TEA-D SHPK me NUIS K32522629L.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 230 803 002 (*dyqind e tridhjetë milion e tetëqind e tre mijë e dy*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. Operatori ekonomik **BEQIRI SHPK, me NUIS J98624801V.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 233 026 230 (*dyqind e tridhjetë e tre milion e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. Operatori ekonomik **C O L O M B O SHPK, me NUIS J82916489E.**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave është 241 952 686 (*dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

❖ operatorin ekonomik **BIBA-X SHPK , me numër NUIS K32618815N**, konstatoi mangësitë si më poshtë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumentave të tjera shoqërues të ofertës bazuar në nenin 26, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dorëzuar pranë AK, konstatoi mangësi dhe parregullsi, si më poshtë:

➤ Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma “b” të DST-së, për disponimin e kapacitetet teknike “Fabrikë asfaltobetonit - 1 copë – në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi”, OE ka dorëzuar fizikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratën e shitjes së pasurisë të pajuaftshme, datë XXXXX;
- Faturën tatimore të shitjes me numër serial: XXXXXXXXX, date;
- Çertifikatën për vërtetim pronësie, datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë,
- Certifikatën ISO 9001:2015, me numër: XXX, lëshuar në datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.XXXX,
- Lejen e Mjedisit Tipi B, numër: XXX, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit më datë XX.XX.XXXX dhe me afat vlefshmërie “Pa afat”,
- Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B nr: XXXX datë XX.XX.XXXX, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Dokumentin “Distanca e vendodhjes së impiantit të asfaltobetonit të shoqërisë “BIBA-X” nga objekti i prokurimit, në të cilën pasqyrohet distanca nga fabrika e asfaltobetonit deri në qendrën e qytetit të Fierit prej 54.2 km.

Referuar dokumentacionit provues si më lartë, KVO kreu verifikimin në terren për përcaktimin e largësisë ndërmjet qendrës së qytetit Fier dhe adresës së fabrikës së asfaltobetonit (me adresë Autostrada Durrës-Rrogozhinë (50 m pranë karburant

"Eurodrin"). U mat largësia me mjet transporti, ku u regjistrua largësia prej 53.3 km nga fabrika e asfaltobetonit deri në qendrën e qytetit Fier.

Pra, fabrika e asfaltobetonit ka një largësi më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit në kundërshtim me largësinë e përcaktuar nga AK në kriterin 2.3.5, gërma "b".

Referuar kontratës së paraqitur për vërtetimin e pronësisë së fabrikës së asfaltobetonit "Kontratë shitje pasuri e paluajtshme", nuk është në formën e kërkuar nga ligji, pasi referuar nenit 83 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet se: *"Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji"*, po kështu, nuk provohet lidhja e veprimit të kryer për kalimin e pronësisë (send i paluajtshëm) me dokumentacionin shoqërues të saj (çertifikatë pronësie e llojit "are"). Mungon dokumenti i pronësisë së fabrikës së asfaltobetonit në pronësi të shitësit të përmendur në kontratën e shitjes së sipërcituar.

- Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.5, gërma "a" të DST-së, për disponimin e mjetit "Greider", OE ka dorëzuar vetëm faturën doganore nr.75363, datë 17.08.2008. Bazuar në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makunave teknologjike*" përcaktohet se: *"Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje e cila përmban të dhënat e regjistrimit"*. Pra, si dokumentacion provues për mjetin "Greider", OE BIBA X SHPK në përmbushje të kriterit të DST, duhet të kishte paraqitur: lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikatën e pronësisë së mjetit, dokumentacion i cili mungon.
- Si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit 2.3.3, të DST-së, OE i kualifikuar i pari duhet të dorëzonte pranë AK, dokumentat provuese si më poshtë:
 - a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Janar 2025**.
 - b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Janar 2025**.

Në dokumentacionin e dorëzuar pranë AK është konstatuar së ka dorëzuar:

-Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Janar 2025**;

-**Vërtetimin** nr.T10477393, **datë 21.02.2025**, "*Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin -E-SIG02/a*", lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM, i cili nuk përmban periudhën tatimore **Janar 2025**, siç kërkohet në DST, por përmban periudhën tatimore deri më **Shkurt 2024**.

- Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, u konstatua se mungonte dokumentacioni original ose i njehësuar me origjinalin:

- dokumentacioni sqarues në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, dokumentacion të cilin OE e ka ngarkuar në SPE.
- Si dhe mungojnë një pjesë e faturave elektronike të ngarkuara në SPE si pjesë e ofertës ekonomike, por që OE nuk i ka dorëzuar fizikisht.

❖ operatorin ekonomik pjesëmarrës **A.L-ASFALT SHPK, me numër NUIS K81511508A**, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 8, “*Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, në pikën 2.3.2, gërma “c”, përcaktohet se:

“2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për realizimin e objektit të kontratës.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Buldozerist 3 (tre); (në listë pagesë ose me kontratë pune)
- Automakinist 1 (një); (në listë pagesë ose me kontratë pune)
- Shofer me leje drejtimi C 2 (dy); (në listë pagesë ose me kontratë pune)

Për specialistet e sipercituar duhet të paraqiten deshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre, si dhe kontrate individuale të punës e vlefshme për të pakten periudhën e parashikuar të zbatimit të kontratës.

Shënim: Për pikat **a)**, **b)** dhe **c)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a)**, **b)** dhe **c)** të pikes 2.3.2, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”

Referuar formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9, ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik A.L-ASFALT SHPK, me numër NUIS K81511508A, rezulton se nuk ka dhënë informacion në lidhje me kërkesën për: “*Shofer me leje drejtimi C 2 (dy); (në listë pagesë ose me kontratë pune)*”, duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.2, gërma “c” të shtojcës 8 të DST-së.

❖ operatorin ekonomik pjesëmarrës **ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK, me numër NUIS K91628013D**, konstatoi mangësitë si më poshtë:

Referuar Shtojcës 8, “*Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, në pikën 2.3.5, gërma “b”, përcaktohet se:

“2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë kapacitetet teknike si më poshtë:

“Fabrikë asfaltbetoni - 1 copë – në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi.

Shënim: Për pikën 2.3.5 (b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën të plotësuar rregullisht me të gjitha të dhënat e kërkuara për kualifikim në këtë pikë, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.5 (b), duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për fabrikën e asfaltobetonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi dokumentin që vërteton pronësinë, Leje mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKL).

Nëse **fabrika e asfaltobetonit** nuk është në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton posedimin e fabrikës (Kontratë qeraje e vlefshme, marreveshje furnizimi e vlefshme, etj.) e shoqeruar me dokumentin e pronësisë, dhe me Leje mjedisore me kod III.1.B (lëshuar nga QKL).

Vendodhja e fabrikes duhet të jetë në një largësi jo më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit, pasi është parashikuar të shtrohen jo vetëm e rruget brenda qytetit të Fierit por edhe rrugë në njesite administrative të Bashkisë Fier.

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE:

- shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku ka deklaruar si më poshtë:

Kontratë Furnizimi		
Fabrike asfalto-betoni	Nr.Rep.923 Nr.Kol.389	11.02.2025 deri në perfundim të punimeve

- kontratë furnizimi nr. 923 rep., nr.389 kol., datë 11.02.2025, lidhur midis subjektit ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK dhe subjektit BIBA-X SHPK. KVO konstaton se fabrika e asfaltobetonit, objekt i kësaj kontrate furnizimi, referuar dokumentacionit bashkëngjitur, rezulton se është e njëjta fabrikë me të cilën subjekti BIBA-X ka ofertuar si operator ekonomik më vete në këtë procedurë prokurimi, nga ku rezulton i skualifikuar për arsye se kjo fabrikë ndodhet në një largësi afërsisht 54 km nga qendra e qytetit të Fierit. Pra, fabrika ka një largësi më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit në kundërshtim me sa është kërkuar në kriterin 2.3.5, gërma “b”.

Në këto kushte, rezulton që operatori ekonomik ALKO IMPEX CONSTRUCTION SHPK të skualifikohet për arsye të mospërmbushje të kriterit 2.3.5, gërma “b”.

- ❖ operatorin ekonomik pkjesëmarrës **PE - VLA - KU SHPK, me NUIS K61716013M**, konstatoi mangësitë si më poshtë:

Nga verifikimi i shtojcës 3 “Lista e çmimeve sipas zerave të preventivit”, ngarkuar në SPE, KVO konstaton se:

-për zërin me nr. rendor 1, është pasqyruar “Asfalt”, ndërkohë që ky zë në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit, të AK është kërkuar “Asfaltobeton (për realizimin shtresës $t=4cm$)”,

- për zërin me nr. rendor 2, është pasqyruar “Binder”, ndërkohë që ky zë në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit, të AK është kërkuar “Binder (për realizimin e shtresës $t=6 cm$)”,

-për zërin me nr. rendor 3, është pasqyruar “*Stabilizant*”, ndërkohë që ky zë në shtojcen 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit, të AK është kërkuar “*Stabilizant (për realizimin e shtresës t=10 cm)*”,

Gjithashtu, KVO më datë 03.03.2025 i është drejtuar operatorit ekonomik PE - VLA - KU SHPK nëpërmjet SPE me kërkesën për sqarim në lidhje me vendndodhjen e fabrikës së asfalto-betonit, pasi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit kjo e dhënë mungon (në formularin përmbledhës është deklaruar se disponon fabrikë asfalto-betoni, sipas kontratës së qirasë nr.Rep 1054, nr.Kol 497, data: 19/02/2025, me shoqërinë “ALESIO-2015” shpk).

Operatori ekonomik, në lidhje me kërkesën për sqarime të nevojshme bërë nga KVO si më sipër, **nuk u përgjigj** brenda afatit të përcaktuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 92 të Ligjit nr.162/2020, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, si dhe nenit 82 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit*”, oferta e operatorit ekonomik PE - VLA - KU SHPK, me NUIS K61716013M skualifikohet.

❖ bashkimin e operatorëve ekonomik **COGREN SHPK me NUIS J74818825K & JODY-KOMPANY SHPK me NUIS J94824803M & TEA-D SHPK me NUIS K32522629L**, konstatoi mangësitë si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 8, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 1.a, kërkohet:

“*a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*”

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në S.P.E nga O.E. **TEA-D SHPK me NUIS K32522629L**, rezulton se ky formular nuk është sipas shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në S.P.E nga O.E. **COGREN SHPK me NUIS J74818825K**, rezulton se ky formular nuk është sipas shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa i përket **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) referuar Dokumentave të Tenderit të Autoritetit Kontraktor, në **Pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**, ndër të tjera është edhe deklarata si më poshtë:

“Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____”

Nga Verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga ana juaj, është konstatuar se kjo deklaratë nuk gjen pasqyrim duke sjellë mospërputhje midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të DST nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier dhe Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar nga ana juaj në SPE "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit."

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se oferta ekonomike përmban gabime aritmetike.

Konkretisht, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kryer kontrollin aritmetik të ofertës së paraqitur sipas Shtojcës 2 "Listat e çmimeve sipas zërave të preventivit", ku ka rezultuar se nga shumëzimi i sasisë me çmimin për njësi, vlera që përfitohet nuk është e njëjtë me shumën e paqyruar në Shtojcës 2 "Listat e çmimeve sipas zërave të preventivit" ngarkuar në SPE nga ana juaj.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3, gërma "a" të nenit 82 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", në kushtet kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, oferta refuzohet.

3. Në akt marrëveshjen Nr. 009 Prot., Sarandë, më 17/02/2025, "Për bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive tregtare" mes COGREN SHPK me NUIS J74818825K & JODY-KOMPANY SHPK me NUIS J94824803M & TEA-D SHPK me NUIS K32522629L, në nenin 3 është përcaktuar pjesëmarrja si më poshtë:
"2. Pjesëmarrja e palëve e shprehur në përqindje si për investimin në arritjen e objektit të kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit të jetë konkretisht:
a) "**COGREN**" shpk do të ketë një pjesëmarrje **69.00%** e shprehur në vlerë **respektive**;
b) "**TEA-D**" shpk do të ketë një pjesëmarrje **16.00%** e shprehur në vlerë **19,982,000** lekë pa tvsh;
c) "**JODY KOMPANI**" shpk do të ketë një pjesëmarrje **15.00 %** e shprehur në vlerë **19,982,000** lekë pa tvsh;"

Ndërkohë referuar pasqyrimin të ndarjes së furnizimit në dokumentin e ngarkuar në SPE nga BOE, vërehet se Punët janë ndarë si më poshtë:

- COGREN 69% dhe shuma pa tvsh 159,243,120
- JODY COMPANY 16% dhe shuma pa tvsh 36,936,000
- TEA-D 15% dhe shuma pa tvsh 34,623,882

KVO konstaton se ka mospërputhje në ndarjen e punëve në përqindje dhe vlerë të shprehura në marrëveshjen e bashkëpunimit me ndarjen e punëve në përqindje dhe vlerë shprehur në pasqyrën e ndarjes së furnizimit.

Gjithashtu, vlerat që rezultojnë nga ndarja në përqindje sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit, vlerave respektive të pasqyruara në pasqyrën e ndarjes së furnizimit dhe përlogaritjes së bërë nga KVO, kanë mospërputhje.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: "*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në*

dokumentet e tenderit”, oferta e B.O.E COGREN SHPK me NUIS J74818825K & JODY-KOMPANY SHPK me NUIS J94824803M & TEA-D SHPK me NUIS K32522629L skualifikohet.

PASQYRA E NDARJES SE FURNIZIMIT SIPAS PERQINDJES SE KONTRATËS SE BASHKËPUNIMIT

“Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-35889-01-23-2025

Emri dhe numri unik i identifikimit: JV COGREN shpk (J74818825K) + JODY KOMPANY shpk (J94824803M) + TEA-D shpk (K32522629L)

Nr	Zeri i punës	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlefte	COGREN		JODY KOMPANY		TEA-D	
							68.00%		16.00%		15.00%
1	Aufaltubeton (për realizimin shtrësisë 1*4cm)	ton	1,127.92	4,500	15,226,920.00	1,127.92	15,226,920.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Binder (për realizimin e shtrësisë 1*6 cm)	ton	13,506.11	3,400	137,762,322.00	11,843.00	120,798,600.00	0.00	0.00	1,663.11	16,963,722.00
3	Stabilizant (për realizimin e shtrësisë 1*10 cm)	m3	16,211.20	1,600	77,813,760.00	4,837.00	23,217,600.00	7,695.00	36,936,000.00	3,679.20	17,660,160.00
	Shuma pa tvsh	lek			230,803,002.00		159,543,120.00		36,936,000.00		34,623,882.00
	TVSH 20%	lek			46,160,600.40		31,848,624.00		7,387,200.00		6,924,776.40
	Shuma me tvsh	lek			276,963,602.40		191,391,744.00		44,323,200.00		41,548,658.40

Nënshkrimi i ofertuesit JV COGREN shpk + JODY KOMPANY shpk + TEA-D shpk



- ❖ operatorin ekonomik **C O L O M B O SHPK, me NUIS J82916489E**, konstatohet mangësitë si më poshtë:

Bazuar në dokumentat standarte të tenderit për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik duhet të përmbushë kriterin si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **90 000 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës; **dhe**,
- Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Bazuar në dokumentacionin e ngarkuar në SPE (sistemi elektronik i prokurimeve), për përmbushjen e këtij kriteri nga Operatori ekonomik “**C O L O M B O SHPK, me NUIS J82916489E**” sh.p.k, janë paraqitur përkatësisht:

- Kontratë nr.9153 prot., datë 12.11.2020, me objekt “Ndërtim rrugët “Marin Barleti”, lidhur midis Bashkisë Kamëz dhe BOE COLOMBO SHPK & NDERTIMI SHPK, kontratë e cila **nuk është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**
- Kontratë nr.883 prot., datë 26.11.2018, me objekt “Mirembajtje Rutine me Performance rruga Fier-Ballsh-Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga Metohasim - Kafaraj + rruga KIRruga Nacionale-Bylis 63.3 kmv”, lidhur midis Drejtorisë Rajonale Jugore Gjirokastrë, ARRSH dhe BOE COLOMBO SHPK & DON JURGE SHPK, kontratë e cila **nuk është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**
- Kontratë nr.8730 prot., datë 14.11.2023, me objekt “Ndërtim trotuare+KUB+ndërtimi i rrugëve Paskuqan (Rr. Ahmet Zogu + Rr. Leka Zogu + Rr. Ali Kelmendi + Rr. Dragobia Kamëz”, Bashkia Kamëz”, lidhur midis Bashkisë Kamëz dhe BOE COLOMBO SHPK & RROKU GUEST SHPK.
- Kontratë nr.1812/1 prot., datë 06.09.2023, me objekt “Trajtim rreshkitje rrugë fshati Peshkepi””, lidhur midis Bashkisë Selenicë dhe COLOMBO SHPK.
- Fatura elektronike nga subjekti mbështetës VARAKU E SHPK, ku janë ngarkuar dokumentacione me emërtime: “*FATURAT PUNE E NGJASHME E RE.pdf,*”
VARAKU_E_PUNE_E_NGJASHME_ASFALT_2023.pdf
VARAKU_E_PUNE_E_NGJASHME_ASFALT_2024.pdf
VARAKU_E_PUNE_E_NGJASHME_ASFALTE_2024.pdf
VARAKU_E_PUNE_E_NGJASHME_ASFALTI_2024.pdf
për furnizimet e mëparshme të ngjashme, një pjesë e të cilave janë të përsëritura disa herë.

Nga mbledhja aritmetike kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezulton se vlera totale e këtyre faturave dhe kontratave të ngjashme rezulton të jetë një vlerë më e vogël se vlera e kërkuar sipas DST, prej jo më pak se **90 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Pra, vlera totale e kontratave të mëparshme, të ngjashme, përfshirë edhe faturat elektronike të subjektit mbështetës VARAKU E SHPK, të hedhura në SPE nga ana e OE “C O L O M B O” SHPK nuk e arrin vlerën e kërkuar prej jo më pak se 90 000 000 lekë pa TVSH që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës sipas DST-së.

KVO vlerëson se nga ana e OE nuk plotësohet kriteri i veçantë i kualifikimit 2.3.1 sipas DST-së lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme, duke përbërë shkak për skualifikimin e ofertës së tij

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

Operatorin ekonomikë G.P.G. COMPANY SHPK, me NUIS J64324443V.

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave **165 098 873** (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Etj. _____

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Bashkia Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15. brenda 10 (dhjete) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☒ JO ☐

Nëse Po (Vendim me Nr.487/2025 me nr. 765/7 prot., date 11.04.2025 i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTARI I AUTORIZUAR**

Zv.Kryetar

Vasil BREGU